



Thirrje per shprehje interesi

Projekti: “ConsumelessMed”

Në kuadër të Projektit **Consume-less** publikohet kjo thirrje drejtuar subjekteve ekonomike që operojnë në sektorin e turizmit ne territorin e Bashkise Sarande (hotele & struktura akomoduese, bare & restorante, stacione plazhi & tregetore), të cilat zbatojnë në veprimtarine e tyre aksione që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të energjisë, ujit dhe mbeturinave.

Duke i ofruar klientëve shërbime/produkte që minimizojnë konsumin e ujit, energjisë, emetimin e CO2, qe promovojne produktet vendase tek turistët, vlerësojne kontekstin social dhe ekonomik të territorit, elemente kyç te strategjisë së turizmit të qëndrueshëm, keto subjekte kontribuojne ne promovimin parimeve te markës "ConsumelessMed" dhe jane te denje te perfitojne prej saj.

Ftojme subjektet e interesuara të shprehin interesin duke dorezuar formularin e aplikimit (Shtojca 1) për aderimin ne skemen e markës ConsumelessMed.

Keto subjekte duhet te dergojne gjithashtu informacionin e nevojshëm sipas veprimtarise qe kryejne duke plotesuar edhe (Shtojcen 2) perkatese. Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit dhe pyetësorin e plotësuar (Shtojca 1 & Shtojca 2) në dy forma:

A. Email: msconsumeless@yahoo.com ose

B. Postë në adresën: Bashkia Sarandë

Për më shumë informacion të detajuar bashkëlidhur do të gjeni:

Formularin e aderimit si edhe pyetësori për tu plotësuar sipas llojit të strukturës (hotele dhe struktura akomoduese, kampinge, bare dhe restorante, tregetore dhe qendra artizanati, stacione plazhi):

- Shtojca _1_Formulari i aderimit
- Shtojca _2_pyetësori per bar e ristorante
- Shtojca _2_pyetësori per strukturat akomoduese
- Shtojca _2_pyetësori për dyqane ushqimore dhe artizanati
- Shtojca _2_pyetësori për stacione plazhi

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!